

KERKESE PER AUTORIZIM
E SUBJEKTIT NEN MBIKEQYRJE ELEKTRONIKE
PER TE DALE NGA ZONA E LEJUAR
APO PER TE HYRE NE ZONEN E NDALUAR.

Emër	
Mbiemër	
Atësia	
Gjinia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Itinerari i saktë/Adresa e plotë e destinacionit të qëndrimit e vlefshme gjatë periudhës së autorizimit	
Lloji i dokumentit të identifikimit	Pasaportë Kartë identiteti
Nr. personal i mjetit të identifikimit	

Arsyeja e kërkesës për autorizim

(shënoni me kryq (X) njërën prej arsyeve të paraqitura më poshtë e cila përkon me arsyen për të cilën jeni duke kërkuar autorizimin dhe për të cilën disponohet dokumentacioni mbështetës i parashikuar).

Sëmundje e rëndë * e anëtarit të familjes**

Vdekje e një anëtari të familjes**

Martese e subjektit apo një anëtari të familjes**

Lindje të fëmijës, fëmijës, motrës apo vëllait

Kohëzgjatja e kërkuar ***

(shënoni sasinë e orëve/ditëve të kërkuara, datën dhe orën e fillimit/mbarimit, kohë gjatë së cilës autorizimi do të jetë i vlefshëm)

Gjithsej - ditë, dhe orë

Duke filluar nga ora , dt. deri më ora , dt.

* "Semundje te rende" nenkuptohet çdo semundje qe lidhet me çrregullime fizike qe cenojne ose vene ne rrezik ne menyre te dukshme integritetin fizik ose jeten e anetarit te familjes se subjektit ne ate mase qe mund te sjellin si pasoje vdekjen e tij dhe per kete shkak kerkon perkujdesje te veçante mjekesore apo familjare.

** "Anetare te familjes" se subjektit nen mbikeqyrje elektronike nenkuptohen nena, babai, femijet, motra, vellai, bashkeshorti/ja.

*** Autorizimi mund te jepet deri ne 7 dite dhe me kerkese te subjektit ne mbikeqyrje elektronike, vetem per rastet e semundjeve te renda mund te zgjatet per aq kohe sa e diktojne rrethanat. Ne çdo rast kohezgjatja e autorizimit nuk mund te jete me shume se 30 dite.

Dokumentacioni i detyrueshëm për t'u paraqitur bashkëngjitur me këtë kërkesë sipas arsyes së përzgjedhur:

Pavarësisht nga arsyeja për kërkesën për autorizim, është e detyrueshme që kësaj kërkesë t'i bashkëngjitet kopje e dokumentit të identifikimit të subjektit (pasaportë, kartë identiteti).

Sëmundje e rëndë e anëtarit të familjes

a) *Certifikatë të zyrës së gjendjes civile që provon lidhjen familjare me të sëmurin,*
b) *Epikrizë mjekësore - në raste sëmundje të rëndë, të leshuar nga spital publik apo privat ku është trajtuar ose trajtohet familjari i sëmurë. Epikriza mjekësore duhet të paraqitet brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të saj dhe duhet:*

- i. të përmbajë datën e lëshimit të saj, datën e shtrimit/trajtimit në spital, numrin e kartelës, pavionin ku është/ishte shtruar/trajtuar;*
- ii. të përmbajë firmën e 3 mjekëve, vulat personale të tyre;*
- iii. Të konfirmohet nëpërmjet nënshkrimit të Drejtorit të institucionit mjekësor, si dhe të vuloset me vulën e institucionit;*
- iv. të shoqërohet ose të përmbajë të dhëna mbi institucionin mjekësor, duke përfshirë: adresën dhe numrin e telefonit, si dhe numrin e telefonit të mjekëve dhe Drejtorit të institucionit mjekësor.*

Vdekje e një anëtari të familjes

a) *Certifikatë të zyrës së gjendjes civile (që provon lidhjen e subjektit me anëtarin e familjes që ka vdekur);*
b) *Certifikatën e vdekjes (ose skedën e vdekjes të anëtarit të familjes të subjektit lëshuar nga autoriteti shtetëror apo vërtetimin e lëshuar nga mjeku i zonës, qendra shëndetësore, spitali apo urgjenca përkatëse, ku ka ndodhur vdekja, në përputhje me ligjin nr.10129 dt11.05.2009 “Për gjendjen civile”).*

Martese e subjektit apo një anëtari të familjes

a) *Certifikatën e martesës të anëtarit të familjes së subjektit (ose kërkesën për shpalljen e martesës lëshuar nga komuna ose bashkia ku secili nga bashkëshortet e ardhshëm ka vendbanimin apo vendqendrimin);*
b) *Vërtetimet e njërive vendore që vërtetojnë datën e zhvillimit të ceremonisë së martesës nga të dy bashkëshortët.*

Lindje të fëmijës, fëmijës, motrës apo vëllait

Certifikatën e lindjes apo vërtetimin nga organi shëndetësor shtetëror apo privat, që sipas ligjit nr.10129, dt.11.05.2009 “Për gjendjen civile” ka të drejtë të vërtetojë lindjen dhe njoftimin për lindjen e ndodhura.

Kujdes! Pamundësia për të paraqitur bashkëngjitur me kërkesën, dokumentacionin përkatës siç është përshkruar më lart, do të rezultojë në refuzimin e kërkesës.

Data e kërkesës:

Subjekti

(Emër, Mbiemër, nënshkrimi)

Për subjektet e mitur

Prindi/Kujdestari ligjor

(Emër, Mbiemër, nënshkrimi)
